

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuara Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Në vend që të përsëris edhe unë konstatimin e mungesës së Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe të ministrave të linjës në lidhje me buxhetin e shtetit në këtë debat, që do të konsiderohej për çdo parlament serioz si më madhori pas votëbesimit të një qeverie, kufizohem duke falënderuar vetëm zonjën Kryetare dhe ministret e mbetura për durimin e tyre, duke u diferencuar nga kreu i tyre. Dëgjojmë gjatë gjithë seancës së sotme deputetët e maxhorancës dhe ministrat me në krye Kryeministrin, renditjen në mënyrë triumfale të shifrave me një intonacion dhe ritëm, që duket sikur synon t'i paraprijë çdo kontestimi të tyre nga salla dhe pyetja e parë që më vjen ndër mend është: po unë a jetoj në një vend me këto zonja dhe zotërinj?! A jetojmë në të njëjtën shoqëri me të njëjtët bashkëqytetarë që kanë probleme, shqetësime dhe halle, të cilat nuk kanë asnjë të krahasuar me hartimet e recituara nga ky podium?! Dëgjojmë vetëm shifra, thua se buxheti i shtetit është matematikë, apo shkencë. Jo, zotërinj, buxheti i shtetit, sikurse edhe ekonomia, nuk është veç një akt politik, por është një vendim politik i caktuar, zgjedhje politike në një realitet politik, ekonomik dhe shoqëror të caktuar. Realiteti ynë është i zyrtë. Nëse do të kishit pak realizëm në qëndrimet tuaja politike dhe në zgjedhjen politike në formën e buxhetit që na keni prezantuar gjatë ditëve të fundit në komisione dhe sot në seancë plenare, kryefjala e debatit duhet të ishte varfëria dhe lufta kundër varfërisë.

Më lejoni t'ju përmend konstatimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar të bëra publike në muajin maj të vitit në vazhdim, ku në vendin tonë, koeficienti i të ardhurave për frymë, sipas standardeve të fuqisë blerëse, është 5,5% më i ulët se ai e Bosnje Hercegovinës, 32-33% më i ulët se i Serbisë nga vendet e rajonit dhe është vetëm sa 1/3-ta e mesatares së vendeve të Bashkimit Europian. Cili është aspekti më negativ se ky?! Për nga koeficienti i konvergimit, ndërkohë që midis viteve 2008-2011 mesatarja e vendit tonë arriti në 31% të mesatares së vendeve të Bashkimit Europian, jemi në vendnumëro që nga viti 2011 deri në vitin 2019, pra, jemi sa 1/3-ta e mesatares së Bashkimit Europian. Nëse vazhdojmë të ecim me këto ritme, në mënyrë që ne të kapim mesataren 50% të mesatares së BEsë, na duhen plot 100 vjet në kushtet laboratorike, ku ne vetëm do të zhvillohemi dhe vendet e Bashkimit Europian do të jenë në stanjiacion. A e kuptoni se cili është realiteti?! Nuk ndihet askush në këtë sallë për këtë çështje. Edhe ministrja e Mbrojtjes Sociale krahas Shëndetësisë, e ka harruar këtë pjesë të dytë të emërtesës së detyrës së saj kushtetuese. Është edhe një aspekt tjetër, që e përforcon pikërisht këtë argument. Kësaj herë u referohem të dhënave të Bankës Botërore të majit të vitit 2021, që u referohet të dhënave deri në fund të vitit 2020. A e dini se në vendin tonë një në tre banorë jeton nën nivelin e varfërisë relative, me 5,5 dollarë në ditë? A e imagjinoni që në familjet tuaja të rrisni fëmijë dhe t'i edukoni me këto të ardhura?

Pra, zonja dhe zotërinj, sado e madhe të jetë arroganca dhe sado të dehur të jeni nga avujt e pushtetit në mandatin e tretë, në buxhetin e nëntë, që na prezantoni, duhet pak reflektim, sepse një hipokrizi e tillë, natyrisht, është pa kufi. Nga ana tjetër dëgjova për disa projekte, që me gjuhë metaforike do t'i quaja fara unike. Kush nuk i do portet, aeroportet dhe autostradat?! Më kujtohet se një arsimitar në

vendlindjen time, i cili ishte arsimuar në Perëndim dhe ishte në përndjekje nga regjimi komunist, atyre njerëzve, tek të cilët kishte besim u thoshte tri gjëra: uji i pijshëm, komunikacioni dhe elektrifikimi janë të barabarta me civilizim. A ua keni garantuar ju të gjitha komuniteteve në vendin tonë këto tri gjëra elementare që të flisni për satelitë? Zotërinj, ju flisni për aerodromin e Vrionit në Sarandë, por a e dini se për të shkuar nga zona e Rrëzës në Sarandë deri në qytetin e Sarandës duhet po aq kohë sa shkon nga Tirana në Sarandë?! Çfarë do t'u thoni banorëve të atyre zonave? Çfarë do t'u thoni zonave të Pogonit në Gjirokastër dhe të Zagorisë, që për të shkuar deri në Gjirokastër, distancë 10-15 kilometër, u duhen 3-4 orë, kur shumicën e periudhës së dimrit e kalojnë edhe pa energji elektrike?! Përshkruani me tone fantazmagorike, në një kohë që realiteti flet për të kundërtën. Zonja dhe zotërinj, kërkohet racionalitet.

Para dy vjetësh vizitova një komunitet shumë të dashur për mua, me ftesën e tyre, dhe më thanë se do të më prisnin ata në krye të rrugës, sepse me makinën time ishte e pamundur që të shkoja. Megjithëse kisha shkuar dhe rruga ishte në kushte më të mira, kur arritëm në qendër të fshatit pash një shesh madhështor. Fshati në periudhën e dimrit ka 30 banorë. Në një kohë që ishin kryer shpenzime marramendëse për fasadën e quajtur shesh, duhej një xhip, që rrallëkush e disponon në atë fshat, për të shkuar në shesh. Më tragjikja ishte se nga muaji maj deri në muajin nëntor nuk kishin ujë të pijshëm. A do të vazhdoni ende me këtë mentalitet fasadash, duke i konsideruar qytetarët e këtij vendi si aborigjenë, që u jepni një pasqyrë që të argëtohen, duke parë fytyrën e tyre dhe duke harruar mjerimin ku i keni zhytur në fushën e shëndetësisë, të arsimit dhe të përkujdesjes sociale?! Për çfarë ka nevojë ky vend?! A do të ulemi në një moment dhe të diskutojmë seriozisht?! Nuk e di. A e dini sesi i ngjani një qytetari me arsim mesatar, por me ndërgjegje shoqërore shumë më të zhvilluar se shumica që gjenden në këtë sallë parlamenti?! Si ai prindi që në varfërinë e tij ekstreme paratë e pakta i shpenzon për kursin e pianos së gocës së madhe, duke lënë pa qumështin e mëngjesit fëmijën e vogël. Prandaj, zonja dhe zotërinj, ky është buxheti i mirëqenies së shifrave dhe i fatkeqësisë së qytetarëve. Rrjedhimisht është një buxhet i pavotueshëm. Faleminderit!